



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Inspeksioni
Periudha Raportuese	Maj 2018
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Zana Gojani

1. PËRMBLEDHJE

Gjatë muajit maj 2018, mbarëvajtja e punëve ishte në nivelin e duhur, me përjashtime të emergjencave eventuale të paparashikuara, si dhe dinamikës së punës.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

- Organizimi dhe koordinimi i punëve brenda sektorit;
- Ndarjen e punëve dhe detyrave të punë, si dhe kujdesi për angazhimin e plotë të punëtorëve brenda sektorit;
- Njoftimi me udhëzime dhe urdhëresa lidhur me punën në kuadër të sektorit;
- Mbikëqyrja për kryerjen e rregullt të punëve, në përputhje me ligjin dhe aktet tjera;
- Përcjellja e gjendjes në kuadër të sektorëve, identifikimi i problemeve dhe vështirësive, si dhe propozimi i masave për mënjanimin e tyre;
- Përgatitja e planeve dhe raporteve ditore, javore dhe mujore të punës;
- Monitorimi i deponive ilegale në territorin e Prishtinës.

- Vizita nëpër objekte për të cilat kemi pasur njohuri se nuk i zbatojnë rregullat, si dhe vërejtjet paraprake ambientale;
- Inspektim të transportit publik;
- Inspektim të lokaleve afariste sa i përket kushteve sanitare dhe tejkalimit të orarit të punës;
- mbledhja e taksës komunale për shfrytëzim të hapësirës publike etj.;
- Aksione në vazhdimësi në transportin publik;
- Aksione në vazhdimësi për shitës ambulante;
- Kontrollimi i terrenit;
- Ndërprerja e të gjitha ndërtimeve pa leje;
- Kontrollimi sistematik i objekteve me leje;
- Inspektim final i objekteve ndërtimore;
- Rrënimi i objekteve pa leje.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Ndërtim:

- Kontrollimi i terrenit;
- Ndërprerja e të gjitha ndërtimeve pa leje;
- Kontrollimi sistematik i objekteve me leje;
- Rrënimi i objekteve pa leje; Objekt i rrënuar me Aktvendim – 1;
- Fletëthirrje – 100;
- Procesverbale – 97;
- Aktvendime për ndërprerje të punëve – 19;
- Aktvendime për rrënim – 5;
- Objekte të rrënuara – 1;
- Pengim në ekzekutimin e aktvendimeve për rrënim – 0;
- Certifikata të përdorimit – 0;
- Gjoba mandatore – 26;
 - të paguara 4, me vlerë prej 1.200 Euro,
 - të papaguara 22, me vlerë prej 5.400 Euro.

Pylltaria:

- Konfiskimi i 6 m³ dru;
- Fletëparaqitje për kundërvajtje - 4;
- Fletëparaqitje penale – 3.

Rendi komunal:

- Lëndë të pranuara, Rendi komunal – 138;
- Procesverbale, Rendi komunal -82;
- Ankesa të pranuara nga Rendi komunal -12;
- Kërkesa për Rendin komunal – 13;
- Kërkesë për asgjësim të mallit – 3;
- Dëmtim i gypit të ujësjesit – 2;
- Gropim dhe dëmtim i rrugëve dhe hapësirës publike – 2;
- Hedhje e dheut dhe mbeturinave – 2;
- Inspektim-mbikëqyrje higjieno-sanitare, pajisja me pëlqim sanitar – 18;
- Inspektim i produkteve ushqimore, afatet e përdorimit – 9;
- Konstatime – 4;
- Ndotje e rrugës – 1;
- Dëmtim i hapësirës publike të gjelbëruara – 1;
- Rrjedhje uji – 1;
- Shfrytëzim i hapësirës publike pa leje përkatëse – 12;
- Ekspozim i mallit – shitës ambulant – 1;
- Taksi pa leje pune – 20;
- Gjoha mandatore nga Rendi komunal – 4;
- Plane operative në transport publik dhe shitësve ambulantë në vazhdimësi;
- Ftesa në GJKK për Rendin komunal -5.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Spektori i pylltarisë:

- Hartimi i raporteve për muajin maj 2018 dhe dërgimi i tyre Agjencisë Pyjore të Kosovës;
- Llogaritja e fletëparaqitjeve, inicimi i procedurave gjyqësore dhe procedimi i të njëjtave nëpër gjykata kompetente, si dhe kontaktimi me gjyqtarë për harmonizimin e dispozitave ligjore;
- Kontrollimi i terreneve pyjorë dhe transportimi i masës drunore;
- Mbështetja dhe shpjegimi i procedurave për aplikim të marrjes së lejes për shfrytëzimin e pyjeve private;
- Pranimi i palëve , e aktiviteteve tjera;
- Kontaktim dhe bashkëpunim me Drejtorinë Koordinuese të APK-së (Planet e menaxhimit të pyjeve për vitin 2018 etj.

Spektori i Rendit komunal:

- Kontrolle dhe inspektime në terren në vazhdimësi nga ana e inspektorëve.
- Aksione në vazhdimësi në transportin publik dhe për shitës ambulante.

Spektori i ndërtimit

- Kontrollimi i terrenit;
- Ndërprerja e te gjitha ndërtimeve pa leje;
- Kontrollimi sistematik i objekteve me leje;
- Rrënimi i objekteve pa leje.

5. STATISTIKAT

5.1. Takimet me palë

Të dhënat e mëposhtme janë relative:

Sektori i ndërtimit – 150;

Sektori i pylltarisë – 34;

Sektori i Rendit komunal – 200;

Kabineti i drejtorit – 20.

5.2. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër:

Rendi komunal

- Lëndë të kryera – 19;
- Lëndë në procedurë – 103;
- Njoftime nga drejtoritë e tjera – 9;
- Kërkesa nga GJTHDK për plotësim adrese – 30;
- Pezullime nga gjykatat – 73;
- Hedhje poshtë nga gjykatat – 7;
- Dënime nga gjykatat - 17;

Sektori i ndërtimit

- Ankesa – kërkesa të qytetarëve - 188;
- Të shqyrtuara janë – 104;
- Prej tyre kërkesa për pranim teknik - 4;
- Ankesa – kërkesa të pa shqyrtuara (në procedurë) – 86.

Sektori i pylltarisë

- Të hyrat nga pyjet private – 3,400.00 Euro;
- Të hyrat nga pyjet publike – 5,996.06 Euro.

6. SFIDAT

- Mungesa e planeve rregulluese detyron qytetaret të tentojnë për ndërtime pa leje.

- Duke u mbështetur në raportimin e inspektorëve dhe diskutimet e shpeshta me ta për gjendjen në teren:
 - Kemi konstatuar se **shkeljet ligjore- ndërtimet informale**, shumë shpesh ndodhin edhe si pasojë e vonesës tonë (**INSTITUCIONEVE**), me iu pri proceseve me planifikim. Ato-planet diku mungojnë e diku janë në shpërputhje me gjendjen faktike në terren dhe si të tillë vështirë të realizueshëm;
 - Shumë shpesh qytetarët shprehen se kanë qenë dhe janë të gatshëm t’i nënshtrohen procedurave për t’u pajisur me leje përkatëse, por nga pamundësia për t’u pajisur me leje, në njërin anë, dhe nevojat e menjëhershme për banim (rritja e familjes, shtimi i kurorave, kërkesa për banim më kualitativ etj.) i bën ata të zgjedhin zgjidhjen e menjëhershme të banimit, qoftë edhe duke e shkelur ligjin;
 - Shumë shpesh qytetarët deklarojnë se edhe për pasojë të problemeve pronësore (jo gjithmonë për faj të tyre), nuk mund t’i nënshtrohen procedurave për t’u pajisur me leje përkatëse;
 - Nga sa u tha më sipër, dhe duke konsideruar veten tonë (INSTITUCIONET) si shërbyes të qytetarëve, i propozojmë Zyrës ligjore të Komunës së Prishtinës, të shqyrtojnë mundësitë ligjore për hartimin e ndonjë **rregulloreje** ose ndonjë **akti tjetër administrativ** që qytetarëve me kërkesa të tilla dhe në situatat e përshkruara më lart, t’u bëhet një **zgjidhje më e shpejtë** në ndërmjetkohën e prurjes së planeve të reja, revidimit të atyre ekzistuese dhe rregullimit të problemeve pronësore;
 - Përvoja dhe praktika të tilla duhet të ketë, por edhe nëse nuk gjenden, Drejtoria e Inspeksionit - Sektori i ndërtimit, shpreh gjithë gatishmërinë për bashkëpunim me Zyrën ligjore dhe me cilindo institucion tjetër.
 - Kërcënimet e vazhdueshme, si dhe sulmet ndaj stafit janë sfidë, për shkak se nuk ekziston mbështetje as shëndetësore, as financiare;
 - Mungesa e stafit- numri shumë i vogël i inspektoreve shkakton pamundësi të efikasitetit në punë për dy arsye, e para, pamundësia e mbajtjes nën kontroll të terrenit dhe identifikimi i lehtë i inspektorit dhe mbajtja nën presion të vazhdueshëm;
 - Mungesa e automjeteve;
 - Mungesa e aparatëve fotografikë;
 - Lejet e lëshuara nga Drejtoria e Urbanizmit krijojnë konfuzitet për shkak të mos përcaktimit të kuotave vertikale të fundimit të objekteve;
 - Në mungesë të Inspektorit komunal të autorizuar vetëm për banim në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit, sipas Ligjin nr. 04/L-134, për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi, ne nuk kemi arritur të zbatojmë këtë ligj dhe aktet nënligjore;
 - Mënyra e shqyrtimit dhe trajtimit të objekteve me shkallë të lartë të rrezikshmërisë (objekte të banueshme dhe të pabanueshme) pas identifikimit nga inspektorët e ndërtimit gjatë kontrollit ditor, si dhe pas pranimit të kërkesave të shumta nga qytetarët që kemi pranuar në Drejtorinë e Inspeksionit.
-
- Mungesa e lokacionit – (Tregut për shitjen e masës drunore);

- Mungesa e automjeteve për terren;
- Mungesa e lokacionit dhe hapësirës për vendosjen dhe sigurimin e druve të konfiskuara;
- Mungesë e rojeve të pyllit për ruajtja dhe mbrojtjen e terrenit;
- Pamundësia dhe nevoja për hapjen e 2, eventualisht 3 vendeve të reja pune për roje pylli;
- Prerësit ilegalë të pyjeve, (recidivist) të cilët janë të njohur për Policinë, Prokurorinë dhe nuk merren masa adekuate për t'i parandaluara ata.

7. REKOMANDIME :

- Rritja e numrit të inspektorëve;
- Automjete për inspektim tereni;
- Aparate fotografike;
- Sigurimi i kushteve për punë në zyrë, nga aspekti teknologjik (kompjuterë, printerë, etj.)
- Pagesa e rrezikshmërisë;
- Sigurimi në rast fataliteti në punë;
- Furnizim me mjete dhe instrumente matëse.

8. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

- Obligimin e bizneseve për t'u pajisur me leje për shfrytëzimin e hapësirës publike;
- Largimi i deponive ilegale të mbeturinave;
- Largimi i mbeturinave inerte;
- Kontrollimi i sipërfaqeve të gjelbra publike;
- Mbikëqyrja e rrugëve rreth punishteve;
- Inspektim të transportit publik të udhëtarëve dhe mallrave;
- Inspektim i lokaleve afariste, kushteve sanitare, varrosja e kafshëve;
- Inspektim të dëmtimit të rrugëve;
- Inspektim të hapësirave publike etj.;
- Organizimi dhe koordinimi i punëve brenda sektorit;
- Ndarjen e punëve dhe detyrave të punë, si dhe kujdesi për angazhimin e plotë të punëtorëve brenda sektorit;
- Njoftimin me udhëzime dhe urdhëresa lidhur me punën në kuadër të sektorit;
- Mbikëqyrja për kryerjen e rregullt të punëve, në përputhje me ligjin dhe aktet tjera;
- Përcjellja e gjendjes në kuadër të sektorit, identifikimi i problemeve dhe vështirësive, si dhe propozimi i masave për mënjanimin e tyre;
- Përgatitja e planeve dhe raporteve javore, mujore dhe vjetore të punës;

- Inspektim të lokaleve afariste, sa i përket kushteve sanitare dhe tejkalimit të orarit të punës;
- Mbledhja e taksës komunale për shfrytëzim të hapësirës publike etj.;
- Aksione në vazhdimësi në transportin publik;
- Aksione në vazhdimësi për shitës ambulantë;
- Kontrollimi i terrenit;
- Ndërprerja e të gjitha ndërtimeve pa leje;
- Kontrollimi sistematik i objekteve me leje;
- Inspektim final i objekteve ndërtimore;
- Rrënimi i objekteve pa leje.